



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË



Nr. 44 prot

Dt. 22/11/2021

VENDIM

Nr.30, datë 18/11/2021

PËR

**MIRATIMIN E KËRKESËS PËR AUTORIZIM “PËR PËRDORIM
BURIMI UJOR NËNTOKËSOR PËR QËLLIME BLEKTORALE
KUR SHOQËROHET ME INSTALIME TUBACIONESH DHE
NDËRTIME OBJEKTESH”,
SUBJEKTIT FIZIK “KLAUDIA NELI”.**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Drin-Bunë.

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për autorizim “Për përdorim burimi ujor nëntokësor për qëllime blektorale kur shoqërohet me instalime tubacionesh dhe ndërtime objektësh”, subjektit fizik “Klaudia Neli”, me vendndodhje Njësia Administrative Bushat, Bashkia Vau i Dejës, Qarku Shkodër, sipas këtyre koordinatave:

2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Vendndodhja e shpimit

- X=464170
- Y=4640548

- $Z=10$ m.m.n.d
- Prurja e kërkuar: $Q=0.23$ l/s

Pika e shkarkimit

- $X=464237$
- $Y=4640534$
- $Z=10$ m.m.n.d

Prurja që shkarkohet: $Q=0.0138$ l/s

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

NEN KRYETARI I KBU DRIN-BUNË

TONIN DEDAJ

